



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:042377

Datë: 02.05.2019

Numri i dokumentit: 00296910

P.nr.1020/2018

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i përgjithshëm divizioni penal, si gjykatë e shkallës së parë penale, gjyqtari individual Adem Shabani me zyrtares Ligjore Kadishe Shabani, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.1516-9/18 të datës 06.03.2018, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.SH, nga Shtimja, me vendbanim në rrugën nr..., për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 par.1 të KPRK-së, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 23.04.2019, në praninë e përfaqësuesit të akuzës prokurorit të shtetit Avdullah Abedini, përfaqësuesi i KEDS-it A.J dhe të akuzuarit A.SH, të njejtën ditë mori dhe publikisht komunikoi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari A.SH, nga Shtimja, me vendbanim në rrugën, i lindur me datë nga i ati S.. e ëma K... e vajzërisë B..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i marutar, baba i katër fëmijëve, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shfrytëzues i Asistencës Sociale mbrohet në liri, me numër personal

ËSHTË FAJTOR

SEPSE:

- Me dt.26.05.2018, në shtëpinë e tij në rrugën, Komuna Shtime, nga ana e punëtorëve të KEDS-it, me rastin e kontrollimit të njehsorit elektrik, është konstatuar se i pandehuri ka qenë i shkyqur dhe paautorizimin e furnizuesit të autorizuar është kyqur direkt jashtë pikes matëse, ku si pasojë e kësaj energjia e shpenzuar nuk është regjistruar me të cilin veprim ka dëmtuar KEDS-in në shumë prej 217,19 Euro,-

- me të cilën kreu veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 par.1 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të dispozitës së lartë përmendur dhe neneve 4, 7, 17, 23, 41, 42, 43, 51, 52, dhe 73 të KPK-së dhe nen. 365 të KPPK-së e:

G J Y K O N

Të akuzuarit **A.SH**, i shqipton dënim me gjobë në shumën prej 100 (njëqind) Euro dhe me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3 / tre / muaj dhe në të njëjtën kohë urdhëron që dënimet e shqiptuara me gjobë dhe me burgim të mos ekzekutohet nëse i akuzuari në kohën prej 1 /një/ viti pasi ky aktgjykim të merrë formën e prerë nuk do të kryej vepër tjetër penale.

Obligohet i akuzuari që të dëmtuarës KEDS-it Distrikti në Ferizaj ti paguj dëmin e shkaktuar në shumë prej 217,19 Euro,, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Gjykata bazuar në nenin 453 paragrafi 4 të KPPRK-së të akuzuarin A.Sh e ka liruar nga detyrimi i pagesës së shpenzimeve të procedurës penale dhe nga pagesa e taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimin, pasi pagesa e tyre do të rrezikonte gjendjen material të pandehurit dhe personave që ai detyrohet t'i mbështesë materialisht, pasi shëtë shfyrzues i Asistencës Sociale, bazuar në Kartelen e Ndhimës Sociale mbështetur në Aktvendimin nr.17150 i dt.20.02.2018, të cilën e ka prezentuar gjatë gjykimit,që gjindet në shkresat e lëndës.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj Departamenti i Përgjithshëm ka paraqitur aktakuzën me numër PP/II.nr.1516-9/18 të datës 06.03.2018, me të cilën ka ngarkuar të akuzuarin A.SH, nga Shtimja, me vendbanim në rugën nr...., për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 par.1 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar rreth kësaj çështje penale konform nenit 245 par.1 të KPPRK-së me datën 23.04.2019, ka mbajtur shqyrtimin fillestar në të cilin kanë marrë pjesë prokurori i shtetit Avdullah Abedini,përfaqësuesi I KEDS-it A.J dhe I akuzuari A.SH.

Në fillim të shqyrtimit fillestar gjyqtari bazuar në nenin 245 par 2 të KPPRK-së ka konstatuar se i akuzuari në afatin ligjor me kohë së bashku me ftesën për shqyrtim, ka pranuar edhe një kopje të aktakuzës.

Në vazhdim të shqyrtimit fillestar i akuzuari është udhëzuar në kuptim të nenit 246.1 të KPPRK-së pastaj gjyqtari gjykues ka çmuar se të dërguarit e të akuzuarit janë rerspektuar, e më pas prokurori i shtetit ka lexuar atakuzën ndaj të akuzuarit dhe pasi që gjyqtari është bindur se i njëjti e ka kuptuar në tërësi aktakuzën me të cilën është akuzuar, duke vepruar sipas nenit 246 par 4 të KPPRK-së, i ka ofruar mundësi të deklarohet mbi fajësinë apo pafajësinë e tij lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet.

I akuzuari A.SH, në shqyrtimin fillestar për veprën penale që akuzohet ka deklaruar se e ndien vetën fajtorë dhe e pranon fajësinë si në dispozitiv të aktakuzës dhe është e vërtet se pa lejen e tyre është kyçur në rrjet palejen e punëtorëve të KEDS-it, pasi nuk ka mundur të qëndroj në terr, pasi i ka fëmijët të mitur por nuk ka mundësi që të paguaj, i gjendjes jo të mire ekonomike ku të vetmin burim të të ardhurave që merrë ka vetëm ndihmën sociale, edhe në

zyren e ndërmejtësimit nuk ka mundur që të arrij marrëveshje ëasi nuk ka pasur mjete për pagesen e shpenzimit të rrymës së hargjuar, ëshë baba i tre fëmive i ka propozuar gjykatës që me rastin e shqiptimit të sanksionit penal të marr për bazë thekësimet e cekura dhe ti shqiptoj një dënim më të lehtë.

Gjyqtari në kuptim nenit 248 par.1 nën.par.1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe par.4 të KPPRK-së, është e bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajsisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht duke e mbështetur në provat që përmban aktakuza dhe në materialet e prezantuara nga ana e prokurorit të shtetit.

Pas pranimin të fajsisë nga ana e të akuzuarit gjyqtari në kuptim të nenit 248 par.2 të KPPRK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit lidhur me pranimin e fajsisë.

Prokurori i shtetit Avdulla Abedini, ka theksuar se pajtohet me pranimin e fajsisë nga ana e të akuzuarit pasi pranimi i fajsisë është bërë konform ligjit dhe pranimi korrespondon edhe me povat materiale që gjenden në shkresat e kësaj lënde penale dhe kërkon nga gjykata që të njejtin ta pranoj si të tillë.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar se i akuzuari pranimin e fajsisë e ka mbështet në provat që gjenden në shkresat e kësaj lënde penale dhe atë: procesverbali me numër 0724197 i datës 26.05.2018, fatura e datës 29.05.2018, fotografitë e vendit të ngjarjes dhe provat të tjera që gjenden në shkresat e lëndës.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha elementet e veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 par.1 të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin mori pranimin e fajsisë nga ana e të akuzuarit, i gjendjes jo të mire ekonomike ku të vetmin burim të të ardhurave ka vetëm ndihmën sociale, ëshë baba i tre fëmijëve, dhe pranon se nuk ka mundur të mbesë pa furnizim të energjis elektrike, pasi ka fëmijët e moshë jo madhore, ka premtuar se më nuk do të përsërisë veprime të tilla, mbi bazën e këtyre rrethanave gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe rrezikshmërinë konkrete të kësaj vepre penale, dhe në kuptim të gjitha këtyre theksimeve i shqipton dënimin si në dispozitiv të këtijë aktgjykimit duke qenë e bindur se një dënim i tillë është në proporcion dhe raport me peshën e veprës konkrete penale, rrethanave të kryerjes si dhe personalitetin e të akuzuarit dhe me te arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës speciale që i akuzuari të mos kryejë vepra penale si dhe në kuptim të preventivës së përgjithshme të parandalimit të kësaj vepre penale në shoqëri konform nenit 41 të KPRK-së.

Gjykata në mbështetje të nenit 463 par.1 të KPPK-së ka obliguar të akuzuarin që të dëmtuarës KEDS-it Distrikti në Ferizaj ti kompensoj dëmin e shkaktuar në shumë prej 217,19 Euro, pas plotfuqishmërisë se këtijë aktgjykimi.

Gjykata bazuar në nenin 453 paragrafi 4 të KPPRK-së të akuzuarin A.SH, e ka liruar nga detyrimi i pagesës së shpenzimeve të procedurës penale dhe nga pagesa e taksës

për Kompensimin e Viktimave të Krimit, pasi pagesa e tyre do të rrezikonte gjendjen material të pandehurit dhe personave që ai detyrohet t'i mbështesë materialisht, pasi shëtë shfrytëzues i Asistencës Sociale, bazuar në Kartelen e Ndhmës Sociale të cekur në dispozitiv të aktgjykimit.

Nga arsyet e lartë përmendura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
- Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal,
P.nr.1020/18, datës 23.04.2019

Zyrtarja ligjore,
Kadishe Shabani

Gjyqtari
Adem Shabani,

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, për mes të kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2018:042377
Datë: 02.05.2019
Numri i dokumentit: 00296910